## Tatimi në pronë është i rëndësishëm

Të hyrat nga tatimi në pronë janë shumë të rëndësishme për komunën tuaj! Nëse të gjithë paguajnë tatimin në pronë,do të ketë më shumë buxhet për investime që përmirësojnë kualitetin e jetës në komunitetin tuaj!

## Porez na imovinu je važno

Prihodi od poreza na imovinu su veoma važni za vašu opštinu! Ako svi plate porez na imovinu, biće više budžeta za investicije koje poboljšavaju kvalitet života u vašoj zajednici!

## Mal vergisi önemlidir

Mal vergisinden elde edilen gelirler belediyeniz için çok önemlidir! Eğer herkes mal vergisini öderse, belediyenizde hayat kalitesini artıracak (düzeltecek) yatırımlar için daha fazla bütçe olacaktır!


**REPUBLIKA E KOSOVËS**
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS
VLADA KOSOVO /GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Ministarstvo za Privredu i Finansije
Ministry of Economy and Finance



Ky dokument është financuar nga SIDA. Sida jo domosdoshmërisht ndan mendimin për opinionet e shprehura në këtë dokument. Përgjegjësia për përmbajtjen e këtij dokumenti mbetet tërësisht mbi autorin.

Ovaj dokumenat je finansiran od SIDA. Sida obavezno ne deli mišljenje izraženo u ovom dokumentu. Odgovornost za sadržaj ovog dokumenta ostaje u potpunosti na autora.

Bu evrak SIDA tarafından maliye edilmiştir. SIDA mecburi olmadan bu evrakla ilgili ortaya atılan düşünceleri paylaşmaktadır. Bu evrakın içerik sorumluluğu tamamen yazarına aittir.


# I drejtë?

# Pravedno?

# Haklı?



## Ne dëshirojmë që prej tani ta bëjmë më të drejtë!

Vlera e pronës tuaj e përcakton tatimin në pronë të cilin duhet të paguani. Tatimi në pronë do të jetë më i drejtë nëse atributet kualitative të shtëpisë reflektohen në vlerën tatimore.

Prandaj, Komunat në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave (MEF) do të bëjnë rianketimin e të gjitha pronave në Kosovë për të përcaktuar vlerën e re tatimore. Në anketimin e ri kualiteti i jashtëm i ndërtesës do të merret në konsiderim.

## Anketimi

Rianketimi do të fillojë në Shtator 2009 dhe do të përfundojë gjatë vitit 2010. Kjo fletushkë do të shpërndahet në pronën tuaj pak kohë para së të fillojë anketimi në zonën tuaj.

Tash e tutje, vlera tatimore do të ndikohet nga përdorimi primar, zona dhe vendndodhja e ndërtesës suaj. Përveq këtyre, do të merren në konsideratë edhe kualiteti i ndërtimit. Për këtë qëllim, gjatë kësaj periudhe, do të mbledhen informatat sa vijojnë:

- Materiali kryesor i ndërtimit
- Materiali i fasadës
- Lloji i kulmit
- Materiali i kulmit
- Gjendja e ndërtesës
- Qasja në pronën tuaj

Stafi që do të bëjë anketimin nuk ka nevojë të ketë qasje në premisat e brendshme të ndërtesës suaj. Të gjitha të dhënat do të mbledhen përmes inspektimit të jashtëm, fotografimit dhe matjes së ndërtesës nga jashtë.

I gjithë stafi anketues do të ketë kartela identifikuese për të verifikuar pozitën e tyre.

Në websajtin e MEF-it, www.mfe-ks.org, ju mund të gjeni më shumë informata rreth anketimit. Aty mund të gjeni edhe informata të dobishme rreth tatimit në pronë.

## Tatimi në pronë

Vlera e re tatimore që pritet të përcaktohet do të jetë baza e tatimit në pronë e cila duhet të paguhet për vitin 2011.

Për më shumë informata vizitioni www.mfe-ks.org (klikoni te Departamenti i Tatimit ne Pronë) ose vizitoni zyrën komunale të tatimit në pronë.